



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 214/4 Prot.

Tiranë, më 15.07.2020

V E N D I M

Nr.63, datë 15.07.2020

“Mbi përfundimin e procedimit administrativ për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit nr. 520, datë 11.02.2020, të Kryetarit të Bashkisë Cërrik, për lirim nga shërbimi civil të **, për shkak të ristrukturimit të institucionit”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit të protokolluar pranë Komisionerit me nr. 214 prot., datë 19.02.2020 për disa pretendime për paligjshmëri, të ngritura nga ankuesi *****, në lidhje me procedurën e lirimit të tij nga detyra “Drejtor i Zhvillimit Rural”, në Bashkinë Cërrik, për shkak të ristrukturimit të institucionit,

VËREJ SE:

Shtetasi ***** , nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 214 prot., datë 19.02.2020, ka ngritur disa pretendime për parregullsi dhe shkelje të lejuara në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit administrativ të lirimit nga detyra “Drejtor i Zhvillimit Rural”, në Bashkinë Cërrik, për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur gjatë hetimit administrativ të çështjes, ka rezultuar e vërtetuar se nëpunësi ***** , është emëruar rregullisht, pas kryerjes së

procedurës së konkurrimit, në detyrën “Drejtor i Zhvillimit Rural”, pranë Bashkisë Cërrrik, me aktin nr.1194/2, datë 09.05.2016, të njësisë së burimeve njerëzore, ku edhe ka përfitur statusin e nëpunësit civil. Ai, ka vazhduar të punojë në këtë pozicion pune deri në momentin kur, pas miratimit të strukturës së re, me aktin e Kryetarit të Bashkisë Cërrrik, nr. 520, datë 11.02.2020, “Për deklarin e lirimt nga shërbimi civil dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare për nëpunësin civil *****”, është liruar nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Pas analizës të përmbajtjes së akteve administrative, që pasqyrojnë procesin e ristrukturimit të institucionit, konstatohet sa më poshtë:

Me urdhrin nr. 09, datë 21.01.2020, të Kryetarit të Bashkisë Cërrrik, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Cërrrik në kuadër të ristrukturimit, sipas përcaktimeve të Këshillit të Bashkiak nr. 338/2 datë 24.12.2019”, është miratuar struktura e re e Bashkisë Cërrrik. Sipas strukturës dhe organikës që ka qenë në fuqi deri në këtë moment (struktura dhe organika e mëparshme, e miratuar me urdhrin nr 37/1, datë 07.02.2019, “Për disa ndryshme në strukturën, organizative të Bashkisë Cërrrik”), punonjësi ***** mbante pozicionin “Drejtor i Zhvillimit Rural”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Nga analiza dhe krahasimi i strukturës e mëparshme, miratuar me Urdhërin (nr.37/1 datë 07.02.2019, “Për disa ndryshime në strukturën e brendshme organizative të Bashkisë Cërrrik”) dhe strukturës aktuale, miratuar me Vendimin (nr. 9 datë 21.01.2020, të institucionit Bashkia Cërrrik, “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Cërrrik dhe institucioneve nën varësi, bazuar në numrin total të miratuar nga Këshilli Bashkiak”) vërehet se jemi para një rasti të shkurtimit të dukshëm të vendeve të punës. Konkretisht, ndërsa më parë bashkia kishte **72** pozicione pune, në strukturën e re ka vetëm **47** pozicione, pra **25** pozicione pune më pak, ku bie në sy sidomos fakti, që nga 6 pozicione pune të nivelit të mesëm drejtues, janë suprimuar 3 pozicione pune. Në këtë proces është përfshirë dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila ka pasur në përbërje “Drejtorinë e Zhvillimit Rural” ku ankuesi ***** ka qenë i punësuar, në pozicionin “Drejtor”.

Funksionet e mëparshme të pozicioneve të nivelit të mesëm drejtues të shkurtuara, janë përfshirë dhe ndërthurur në njësitë organizative të strukturës aktuale të Bashkisë Cërrrik. Në pozicionet e mbetura dhe të riorganizuara, janë riemëruar drejtor drejtorie nëpunës civilë të cilët ishin pjesë të shërbimit civil të kësaj bashkie dhe plotësonin më mirë kërkesat e posaçme të këtyre pozicioneve.

Pasi ka konstatuar sa më sipër, Komisioni i Ristrukturimit, mbështetur në nenin 50, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka shqyrtuar edhe mundësinë e sistemimit të nëpunësit ***** , në ndonjë nga pozicionet e mbetura apo krijuara pas

ristrukturimit në Bashkinë Cërrik, duke vlerësuar të dhënat e dosjes së personelit, përvojën në punë, llojin dhe nivelin arsimor, kualifikimet e kryera, etj.

Nga ky vlerësim dhe verifikim i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se, për pozicionet e reja të riorganizuar në njësitë e reja të krijuara u përfshinë edhe funksionet që kryente më parë “*Drejtoria e Zhvillimit Rural*” apo drejtoritë e tjera tashmë të suprimuara, duke ndryshuar kriterin arsimor për kandidatët që do të rekrutoheshin, në drejtimin nivel master në shkencë shoqërore ose shkencë inxhinierike, sipas natyrës së punës që do të kryente njësia organizative aktuale.

Duke marrë parasysh faktin se, ankuesi ***** , zotëron diplomë “*Inxhinier Agrar*”, për Akuakulturë dhe Menaxhim Peshkimi, lëshuar nga Univeristeti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Bujqësisë si dhe “*Master*”, në shkencë bujqësore, Komisioni i Ristrukturimit i Bashkisë Cërrik, ka arritur në përfundimin se kualifikimi i tij është specifik dhe nuk përputhet me objektivat apo detyrat e ndonjë prej pozicioneve të mbetura apo riorganizuar pas ristrukturimit, prandaj duke e vlerësuar të pamundur sistemimin e tij, Komisioni i Ristrukturimit, ka propozuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për këtë nëpunës.

Vendimi përfundimtar është marrë nga njësia e burimeve njerëzore e cila, me aktin nr. 520, datë 11.02.2020 “*Për deklarin e lirimit nga shërbimi civil dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare për nëpunësin civil ******”, ka liruar nëpunësin nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Në përfundim, nga analiza në tërësi e dokumentacionit të administruar konstatohet që, veprimet e njësisë përgjegjëse dhe aktorëve të tjerë në këtë proces, janë kryer në përputhje me kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”.

Nga sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në përfundimin se pretendimi i parashtruar nga nëpunësi ***** , nëpërmjet kërkesës të rregjistruar me nr. 214 prot., datë 19.02.2020, për paligjshmëri gjatë procesit administrativ të lirimit të tij nga detyra në pozicionin “*Drejtor i Zhvillimit Rural*”, për shkak të ristrukturimit të institucionit, në Bashkinë Cërrik, nuk qëndron.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenin 34, pika 1, të të

Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 214 prot., datë 19.02.2020, të nëpunësit *****, në lidhje me disa pretendime për parregullsi të kryera apo lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procesit administrativ të lirimit të tij nga detyra në pozicionin “Drejtor i Zhvillimit Rural”, për shkak të ristrukturimit të institucionit, Bashkia Cërrik, pasi nuk u konstatuan parregullsi në administrimin e shërbimit.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Cërrik, njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Cërrik dhe kërkuesi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha